



*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,*

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 67.4 dhe nenit 71.1, dhe 71.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 10.08.2009 nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për pagesën e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ)**

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit për Buxhet dhe Prokurim të KQZ-së i datës 03.07.2009 për kompensimin e secilit anëtarë të KKZ-së, i cili është emëruar jashtë Administratës Komunale në shumën prej dyqind e pesëdhjetë EURO (250.00) Bruto.
- II. Anëtarët e emëruar të KKZ-së, të punësuar nga radhët e Administratës Komunale dhe Shërbyesit e tjerë Civil do të paguhen në lartësinë e gjysmës së pagës së tyre të dhënë nga komuna, si shtesë e pagës së tyre të zakonshme.
- III. Anëtarët e KKZ-së si në pikë I dhe II të vendimit do të paguhen për një periudhë kohore konform nenit 67.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datë 10 gusht 2009.

Prishtinë, 10 gusht 2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve